



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:122224

Datë: 15.08.2024

Numri i dokumentit: 06054259

AC-I-23-0372

Në ankesën e

Paditësi

Q Sh fshati Sh, Podujevë, i Përfaqësuar nga avokati B I, Prishtinë.

Kundër

E paditura/Ankuesja

N.SH "FAN "Zahir Pajaziti", Podujevë (në Likuidim) e cila është e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe, Hasim Sogojeva gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-2795 të datës 07 qershor 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 15 gusht 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së , C-IV-14-2795 i datës 07 qershor 2023.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Reathanat procedurale dhe faktike:

Me 16 prill 2014, paditësi në DHPGJS, parashtrij kërkesë për rishikimin e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL) PRN046-0745 datë 19 mars 2014 me të cilin i është refuzuar kërkesa për kompensimin për shkak të ndërprerjes së parakohshme të punës, në shumë të paspecifikuar, ndaj NSH "Zahir Pajaziti" (në likuidim), me arsyetimin se ishin parashkruar sipas nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Paditësi pohoi se me anë të njoftimit së Agjencisë, datë 24 mars 2006, i është ndërprerë marrëdhënia e punës dhe po me të njëjtin njoftim është informuar mbi të drejtën mbi realizimin e së drejtës në paga të papaguara.

Paditësi konsideron se kërkesa kreditore e tij nuk është e parashkruar, fillimisht duke u mbështetur në nenin 36 por edhe nenin 40 të Shtojcës së Ligjit për AKP. Paditësi, gjithashtu pohon se i është përmbajtur Njoftimit të Agjencisë dhe udhëzimeve të këtij njoftimi, se e drejta e tij mbi pagat e mbetura borxh do të trajtohen në procedurë të likuidimit, të NSH. Paditësi, tutje ka konsideruar se në bazuar në Rregulloret e UNMIK-ut 2001/27 dhe 2005/48, si dhe Ligjit themelor të punës së Kosovës – Rregullorja e UNMIK-ut 2001/27, i takon e drejta në paga të papaguara. Paditësi përfundimisht pohon, se Vendimi i AL është në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit për AKP (nenin 6 dhe 37).

Nga gjitha arsyet propozon që kërkesa e tij kreditore, për përvojën e punës prej 21 viteve 9 muaj e 9 ditë, i takojnë 4 paga, në shumë totale prej 1,213.32 Euro, si kamata ligjore prej 10%. Kërkesës për rishikim i janë bashkangjitur: Kopja e autorizimit për përfaqësuesin, Kopja e Vendimit të AL, Kopja e njoftimit datë 24 mars 2006, lëshuar nga Agjencia, me të cilin paditësi është njoftuar mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës duke filluar nga data 24 mars 2006, Kopja e listës së pagave së paditësit, për muajt janar, shkurt dhe mars të vitit 2006.

Me 23 mars 2023, AKP kundërshtoj ankesën si të pabazuar. Sipas AKP AL me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën e paditësit ka vendosur në mënyrë të drejtë. AKP tutje pohon se paditësi nuk ka ofruar argumente ligjore, në favor të ankesës së tij, ashtu siç parashihet sipas dispozitave ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP. AKP përfundimisht pohon se kërkesa kreditore e paditësit konsiderohet e pabazuar respektivisht parashkruar në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit për AKP, pasi që

kërkesa e tij nuk është parashtruar në afat prej 3 viteve. Nga gjitha arsyet propozoj që ankesa e paditësit të hedhet si e papranueshme ose të refuzohet si e pabazuar dhe Vendimi i AL të vërtetohet. Përgjigjes i ka bashkangjitur Kopja e Vendimit të AL, dhe Vendimi për emërimin e anëtareve të Autoritetit të Likuidimit.

Duke vepruar sipas urdhrit të Gjykatës, përfaqësuesi i ankuesit me 30 mars 2023 parashtror përgjigjen. Paditësi, sikurse edhe me kërkesën e tij për rishikim, kundërshtoj pretendimet e AKP lidhur me parashkrimin. Tutje sipas paditësit, bazuar në librezën e punës së ankuesit si dhe shkresës së menaxhmentit të NSH, shihet se paditësit në bazë të përvojës së tij i takojnë 4 paga. Andaj kërkohet shuma prej 1,213.32 (një dy një tre tre dy) Euro duke përfshirë kamatën prej 8% si dhe shpenzimet e përfaqësimit, në shumë të përgjithshme prej 312.00 Euro, dhe atë në emër të kërkesës pranë AL, shqyrtimit të shkresave, ankesës dhe përgjigjes si dhe kompensimi i 21 (dy një) Euro në emër të taksës gjyqësore. Përgjigjes i është bashkangjitur: Kopja e njoftimit.

Me 07 qershor 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së, ka marrë Aktgjykimin C-IV-14-62795, me të cilin Kërkesa për rishikim të Aktvendimit të Autoritetit të Likuidimit e ka aprovuar si të bazuar, ka shfuqizuar vendimin e AL PRN046-0745 të datës 19 mars 2014 dhe ka Obliguar Autoritetin e Likuidimit- AKP që paditësit në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, ti paguaj shumën prej 1,213.32 Euro, në emër të interesit ligjor prej 10 % t'i paguhet shuma prej 121.33 Euro dhe në emër të taksave gjyqësore shuma prej 20.00 Euro. Ndërsa ka Obliguar AL që përfaqësuesit të paditësit, në emër të përpilimit të kërkesës për rishikim – ankesës dhe përgjigjes ndaj përgjigjes së AKP, të ja paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 208.00 Euro gjersa pjesa tjetër e mbetur prej 104.00 Euro në emër të kërkesës kreditore dhe shqyrtimit është refuzuar.

Shkalla e I-rë kishte gjetur se sipas listës së pagave të punëtorëve e përpiluar nga ana e NSH, listë kjo sipas lëndës C-IV-14-4029, paditësi figuron në këtë listë dhe atë sipas numrit rendor 241, (në tekstin në vijim LISTA E PAGAVE). Sipas kësaj liste shihet se paga mujore e paditësit ishte në shumë prej 303.33 Euro. Kjo listë i është bashkangjitur shkresave të lëndës. Gjithashtu, nga kopja e listës përfundimtare së punëtorëve të cilët kanë përfituar të drejtën në pjesën e 20% nga

privatizimi i NSH, se paditësi ishte i përfshirë me përvojë pune prej 21 vitesh 9 muaj e 9 ditë.

Shkalla e I-rë ka arsyetuar se duke u bazuar në nenin 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP mbi prioritet e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.6 pika 1.6.2 parashihet e drejta në kërkesa për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të sjella nga punonjësit të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në

Nga dispozitat e lartëcekura, mund të konkludohet se, punëtori/ja gëzon të drejtën dëmshpërblim nëse: Kontrata mbi punën i është ndërprerë para afatit të përfundimit, të saj; Pushimi nga puna ka ardhur si pasojë i Vendimit të AL, dhe ndonjë veprim nga Agjencia, lidhur me administrimin e ndërmarrjes, shitjes, likuidimit etj.

Në këtë rast paditësi ka ofruar dëshmi relevante që dëshmojnë se ka qenë punëtor i NSH në kohën e privatizimit të tij dhe se marrëdhënia e punës i ka pushuar si rrjedhojë e vendimit/veprimit të AKP.

Njoftimi, lista për ankuesin, lista e punëtorëve dhe lista e pagave e përpiluar nga NSH, argumentojnë faktin se i njëjti ka qenë punëtor aktiv i NSH-së gjer me datën e privatizimit të saj, respektivisht 24 mars 2006, dhe se paga mujore e ankuesit ishte në shumë prej 303.33 Euro.

AKP, asnjëherë, nuk e ka kundërshtuar shumën e kërkuar nga ana e paditësit, respektivisht nuk e ka argumentuar të kundërtën me çka paditësit do ti mohohet e drejta në kompensimin e pagave. AKP faktet nuk i kontestuar (*positive litis contnestation*) e për më tepër provat e parashtruara, siç u cekën më lart, kanë dëshmuar, vërtetësinë e pohimeve të palës së kundërt, në këtë rast ankuesit. Kjo shihet nga fakti se AKP, edhe si një nga arsyet mbi refuzimin e kërkesës e potencon çështjen e parashkrimit.

Shkalla e I-rë, gjeti se në përputhje me Ligjin e Punës (Ligji nr. 03/L-212), ligj ky në fuqi nga data 15 dhjetor 2010, nenit 76 paragrafi 7 pika 7.4, në kuptim të kompensimit i takojnë 6 (gjashtë) paga mujore. Kjo për faktin se përvoja e paditësit, bie në kategorinë e përcaktuar, sipas dispozitës së cekur si më lartë (20 gjer 29 vite shërbimi).

Por, në rastin konkret, me rastin e vendosjes, gjykata në kuptim të nenin 76.3 të Ligjit për DHPGJS lidhur me nenin 2.1 të Ligjit për procedurën kontestimore –LPK

("vendosja brenda kufijve të kërkesave"), vendosi si në pikën 3 të dispozitiv të aktgjykimit.

Nga gjitha arsyet e dhëna si më lartë gjykata konsideron se ankuesi ka arritur që të dëshmoj të drejtën në kompensim, sipas nenit 40 paragrafi 1.6 pika 1.6.2, të Shtojcës së Ligjit për AKP. Gjykata me rastin e vendosjes lidhur me kamatën ligjore, sipas pikës 3 (tre) të dispozitivit, vepron në pajtim me nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit për AKP lidhur me nenin 2.1 të Ligjit për procedurën kontestimore- LPK.

Lidhur me çështjen e parashkrimit të kërkesave të ankuesit, paditësi, ka pranuar njoftimin, nga Agjencia, dhe me këtë njoftim është informuar si në vijim, citat: Si pasojë e shitjes së asetëve të NSH ky njoftim është njoftim zyrtar se punësimi juaj përfundon menjëherë (*marrëdhënia e punës i ndërprerë me veprim të Agjencisë*), dhe Shumat – pagat e papaguara që u janë borxh do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit (*pranim i borgjit*).

AL me anë të vendimit të saj si dhe AKP në përgjigje ndaj rastit të ngjashëm, lidhur me parashkrimin i referohet nenit 608 pika 1 të Ligjit për punën e bashkuar - LPB (gazeta zyrtare e RSFJ 53/76). Këtë konkludim të AKP-së gjykata e konsideron si aplikim të gabuar të dispozitave ligjore, nga arsyet si në vijim.

Shkalla e I-rë, tutje ka arsyetuar se rregullat për parashkrimin nuk mund të zbatohen sepse veprimi i vetëm i paditësit, në rastin konkret, ishte kërkesa drejtuar pranë Komitetit të Likuidimit e që afatet dhe procedura e likuidimit rregullohet me ligj të veçantë e në këtë rast me Ligjin për AKP (shtocja e ligjit) dhe se përfundimisht afatet rrjedhin nga momenti i njoftimit së procedurës së likuidimit. Përfundimisht procedura e likuidimit të një NSH, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, është e vetmja mënyrë proceduralo - ligjore lidhur me përmbushjen e obligimeve kreditore, si ndaj punëtorëve e po ashtu edhe ndaj kreditorëve tjerë potencial (*lex specialis*). Asnjë punëtor apo kreditor potencial, nuk mund ti realizoj të drejtat e tyre kreditore ndaj një NSH, pa hapjen e procedurës së likuidimit nga ana e AKP, dhe referenca si ajo se parashtruesi nuk ka inicuar rast ligjor, konsiderohet i papranueshëm.

Me 23 qershor 2023, e paditura e dorëzon në DHPGJS një ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-14-2795 të datës 07 qershor 2023, për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljeve të dispozitave të së drejtës materiale, dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që të aprovohet ankesa e saj si e bazuar, të

ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, të refuzohet ankesa e paditësit si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN046-0745 i datës 19 mars 2014. Për më tepër në ankesë e paditura ka pohuar se Gjykata e Shkallës së I-rë është tërësisht jashtë kontestit faktit të çështjes. Autoriteti i Likuidimit ka vërejtur që Gjykata i ka ngatërruar dy çështje krejtësisht të ndryshme nga njëra tjetra përkatësisht dy afate të ndryshme dhe atë afatin për parashtrimin e kërkesave që është afat procedural për të dorëzuar dëshminë e kërkesës në procedurën e likuidimit dhe afatin ligjor për të kërkuar mbrojtjen e të drejtës së pretenduar-afatin e parashkrimit i cili në këtë rast është 3 vjet në bazë të nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Këto dy afate janë të ndara dhe të dallueshme të cilat duhet të përmbushen nga çdo pretendues në mënyrë që të pranohet kërkesa. Tutje AKP-ja ka pretenduar se kërkesa për 3 paga të fundit të papaguara është dashtë të paraqitet brenda tre viteve nga viti 2006, prej kur paditësi nuk ka përfituara të ardhura personale, që nënkupton se kërkesa është parashkruar, në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Me 30 korrik 2024, paditësi e dorëzon në DHPGJS një parashtresë dhe përgjigjet në ankesën e AKP-së. Me të cilën ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës, të vërtetohet Aktgjykimi i atakuar dhe të detyrohet e paditura që të bëjë kompensimin e shpenzimeve të përfaqësimit në bazë të Tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës. Në këtë parashtresë paditësi i ka kundërshtuar pretendimet ankimore të AKP-së dhe ka pohuar se i kundërshton në tersi deklaratimet e të paditurës sa i për ketë afatit të dytë i cili ndërlihet me parashkrimin e kërkesës pasi që gjykata e ka konfirmuar se kërkesa e ankuesit nuk ishte parashkruar dhe mbi këtë bazë ja ka njohur borxhin e të paditurës për paditësin. Gjykata ka konstatuar se kërkesa e paditësit nuk mund të llogaritet e parashkruar për arsye se ankuesi ishte njeri nga punëtoret e ndërmarrjes, i cili me njoftimin e datës 24 mars 206, e lëshuar nga paraardhësja e të paditurës ishte njoftuar se si rezultat i vendimit nga Bordi i Drejtorëve të AKM-së, të kontratës për shitjen e asetëve të NSH-së, punësimi përfundon menjëherë dhe se njoftimi me fjalë përbënte njoftim zyrtar. Për më tepër shumat apo pagat e mbetura borxh nga NSH-ja, mbeten përgjegjësi e punëdhënësit dhe se kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të njoftoheni kur do të fillojnë këto procedura. Andaj ky njoftim përderisa ka parashikuar mundësinë e mbetjes borxh ndaj paditësit dhe kur dihej se i njëjti figuronte në listën e pagave të pa paguara për me

tepër mund të shihet si një bazë për ndërprerjen e afatit të parashkrimit. Nga këto arsye paditësi ka kërkuar nga Kolegji i Apelit që të refuzohet ankesa e AKP-së si e pa bazuar, dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e të paditurës është e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi më 08 tetor 2013 ka paraqitur kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit pran AKP-së me të cilin ka kërkuar kompensim për ndërprerje të parakohshme të punës, por që AL me vendimin PRN046-0745 te dt. 19 mars 2014, kërkesën e tij e ka refuzuar si e pa vlefshme, me arsyetimin se është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me ankesën e tij të dorëzuar në Shkallën e I-rë, por edhe me parashtresat e dorëzuar gjatë procedurës si përgjigje ndaj të paditurës, kërkesën e tij për kompensim për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës e ka mbështetur me prova të mjaftueshme, duke dorëzuar përveç vendimit të Autoritetit të Likuidimit, Kopjen e njoftimit datë 24 mars 2006, lëshuar nga Agjencia, me të cilin paditësi është njoftuar mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës duke filluar nga data 24 mars 2006, kopjen e listës së pagave të paditësit, për muajt janar, shkurt dhe mars të vitit 2006.

Me këto dëshmi paditësi padyshim ka vërtetuar se ai kishte të drejtë që të i njihet e drejta e kompensimit për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës, në shumën prej 1,213.32 Euro, në bazë të përvojës së punës që ai e kishte në NSH.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi në procedurën pranë Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, ka sjellë njoftimin zyrtar të ish AKM-së me të cilën vërtetohet se atij i është ndërprerë marrëdhënia e punës me datë 24 mars 2006. Ky njoftim e ka ndërprerë afatin e parashkrimit. Në bazë të këtij njoftimi, atë ditë është shitur Ndërmarrja në bazë të vendimit të Bordit të ish AKM-së, dhe marrëdhënia e punës paditësit i është ndërprerë menjëherë. Në këtë njoftim thuhej "shumat e pagave që u janë mbetur borxh sipas Kontratës suaj të punësimit do të mbesin në përgjegjësin e punëdhënësit, ndërsa kërkesat do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të kontaktoheni kur të fillojnë këto procedura".

Paditësi duke u bazuar në këtë njoftim ka pritur të filloj procedura e likuidimit ndaj NSH-së, dhe pastaj të paraqesë kërkesën për paga. Paditësi në afatin ligjor ka paraqitur kërkesën e tij tek Autoriteti i Likuidimit me datë 08 Tetor 2013, andaj nuk mund të konsiderohet se kërkesa është parashkruar.

Prandaj duke u bazuar në provat e bashkangjitura, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me të drejtë e kishte aprovuar ankesën e paditësit si të bazuar dhe e kishte ndryshuar vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, pasi që ai vendim nuk mbështetej në dispozita ligjore.

Nga këto arsye, ankesa e AKP-së është refuzuar si e pa bazuar, dhe është vërtetuar Aktgjykimi i ankimuar i shkallës së I-rë të DHPGJS-së si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur sikurse në diapozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksat gjyqësore

Ankuesja e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 12 korrik 2023 në shumë prej 100 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 15 gusht 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues
